

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PER DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9049, DATË 10.4.2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) është një institucion i rëndësishëm dhe me një rol kryesor në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Ky institucion, pavarësisht rezultateve pozitive të arritura gjatë periudhës 2014-2017 dhe vlerësimeve të shumta të marra nga partnerë vendas e ndërkombëtarë, vazhdon përpjekjet për përmirësimin e mëtejshëm të teknikave dhe metodikave investiguese në përmbushje të misionit institucional, veçanërisht atij të deklarimit dhe kontrollit të pasurive.

Në këtë kuadër, ILDKPKI, në zbatim të nenit 4/2 dhe nenit 34 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, i cili i hapi rrugën mundësisë së plotësisht dhe depozitimit të deklaratave elektronikisht, me qëllim jo vetëm modernizimin e sistemit të deklarimit të pasurisë, por edhe rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të kryerjes të kontrollit të deklaratave të interesave privatë për subjektet deklarues, me mbështetjen e vyer të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian, filloi zbatimin e dy projekteve për asistencë teknike dhe financiare.

Kështu, USAID nëpërmjet Projektit “Transparency in Health Engagement”, implementuar nga University Research Co. (URC) prokuroi fondet e nevojshme për pjesën e programimit të sistemit (softëare), duke nënshkruar një kontratë me afat mars 2019 me firmën e përzgjedhur për asistimin e ILDKPKI në zhvillimin, instalimin e programit dhe testimin e funksionalitetit të tij.

Në të njëjtën kohë, Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian nëpërmjet Projektit “Horizontal Facility” prokuroi fondet e nevojshme për blerjen e paisjeve kompjuterike të sistemit (hardëare), duke nënshkruar një kontratë me afat mars 2019 me firmën e

përzgjedhur për asistimin e ILDKPKI në blerjen, instalimin dhe konfigurimin e paisjeve kompjuterike (hardëare).

Aktualisht, ILDKPKI është duke punuar dhe koordinuar proceset ndërmjet të dy donatorëve kryesor USAID/Këshilli i Evropës, në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale lidhur me asistencën e dhënë në ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave private, të cilët pritet të dorëzojnë produktet e tyre brenda muajin mars 2019.

Në këtë kuadër, është e rëndësishme të theksohet fakti se ngritja dhe vënia në funksionim e sistemit elektronik të deklarimit të interesave private vjen jo vetëm si një domosdoshmëri e ILDKPKI për të përmbushur detyrimeve ligjore, në rritjen e efikasitetit në plotësimin, administrimin, kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik, si dhe publikimin e të dhënave në deklaratat e interesave private për konsultim nga publiku dhe palë të tjera të interesuara, por dhe si një angazhim i marrë përkundrejtë partnerëve ndërkombëtarë.

Për më tepër, kjo iniciativë ndërmerret nga ILDKPKI në përmbushje e zbatim të Strategjisë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe Planit të saj të Veprimit, ku, një nga objektivat (*Objektivi A5*), parashikon specifikisht forcimin e regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave nëpërmjet mundësisë të deklarimeve online të pasurisë për të gjithë subjektet deklaruese, si dhe publikimin e deklarave të interesave private pa kërkesë, si faktorë që kontribuojnë në kufizimin e korrupsionit.

Për më tepër, ngritja dhe funksionimi i një sistemi elektronik për deklarimin e pasurive dhe interesave private në Shqipëri, ka ardhur si një kërkesë në përmbushje dhe zbatim të detyrimeve të marra nën Prioritetin 3 “*Lufta kundër Korrupsionit*”, si pjesë e udhërrëfyesit për 5 prioritetet kyçe për integrimin evropian të vendit, si dhe në dritën e rekomandimeve të shumta të instrumenteve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, të cilët kanë evidentuar nevojën e ngritjes së një sistemi elektronik të deklarimit online për ILDKPKI, si një mekanizëm i nevojshëm në luftën kundër korrupsionit.

Të tilla kanë qenë dhe gjetjet në Raportin për Shqipërinë 2018 të Komisionit Evropian, ku është evidentuar nevoja për forcim të mëtejshëm të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të ILDKPKI dhe se një sistem online i deklarimit të interesave private duhet ende të krijohet.

Ky prioritet i përcaktuar nga ILDKPKI ka gjetur mbështetje edhe nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ku në Rezolutën “Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017” janë lënë si prioritet për vitin 2018: “Vazhdimin e ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile. Forcimin e mëtejshëm të urave të bashkëpunimit me median investigative. Respektimi i mekanizmave informues ligjorë e publikë, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të

dhënave personale, për publikimin e deklaratave të interesave private”, si dhe angazhimin e Kuvendit dhe të Qeverisë për të mbështetur institucionin me financime të nevojshme për sigurimin e qendrueshmërisë së sistemit elektronik, të deklarimit të interesave private.

Për sa më sipër, Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”* i ndryshuar, vjen si domosdoshmëri e përsosjes së mëtejshme të kuadrit ligjor aktual për të lehtësuar procesin e ngritjes dhe vënies në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave private, si një mekanizëm i rëndësishëm në forcimin e mjeteve investiguese/kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, me impakt të ndjeshëm jo vetëm në luftën kundër korrupsionit në të gjitha kategoritë e zyrtarëve, të cilët kryejnë funksione publike, por edhe në përmbushjen e pritshmërisë qytetare në rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit të zyrtarët që ushtrojnë funksione publike.

Projektligji përmban 6 nene të cilat rregullojnë dhe përmirësojnë ligjin ekzistues për çështje që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave private si një prioritet i përcaktuar jo vetëm në dokumentat strategjik në luftën kundër korrupsionit, por dhe nën Prioritetin 3 *“Lufta kundër Korrupsionit”*, si pjesë e udhërrëfyesit për 5 prioritetet kyçe për integrimin evropian të vendit në Bashkimin Evropian.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Strategjinë Sektoriale ku në pjesën e 8 “Themelet: Qeverisja e mirë, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës” në pikën 8.9 “Transparenca dhe lufta kundër korrupsionit” në objektivat strategjike përfshihen: “1. Parandalimi i korrupsionit dhe rritja e besimit të publikut nëpërmjet: 1.8 forcimit të regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konflikteve të interesit, nëpërmjet një sistemi online të deklarimit për të gjitha subjektet raportuese dhe mundësinë e publikimit të tyre, veçanërisht për personat në nivele të larta drejtuese dhe të zgjedhurit. 2. Parandalimi i korrupsionit me anë të përmirësimit të procedurave të administratës publike, në veçanti, nëpërmjet: 2.1 forcimit të infrastrukturës elektronike të institucioneve publike dhe automatizimit të proceseve mbështetëse; 3. Ndëshkimi i korrupsionit dhe ulja e pandëshkueshmërisë nëpërmjet: 3.1 efektivitetit më të madh të hetimeve penale kundër krimeve ekonomike dhe financiare, sidomos në fushën e hetimeve parandaluese dhe pasurimit të paligjshëm; 3.2 përmirësimit të bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese, me qëllim procedimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit, me anë të menaxhimit dhe shkëmbimit të informacionit”.

Gjithashtu, Projektligji është në përputhje të plotë me vetë Deklaratën e prioriteve të Qeverisë, ku prioriteti i parë kërkon “(1) shërbime publike inovatore, që kanë në qendër qytetarin (qeverisja e mirë)”, çka përputhet plotësisht me shërbimet që do të ofrohen nëpërmjet ngritjes dhe vënien në funksionim të sistemit online të deklarimit të pasurive.

Për më tepër, ngritja dhe vënia në funksionim e sistemit online të deklarimit të pasurive është në përputhje me:

- Objektin A5 të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe Planit të saj të Veprimit, ku parashikohet specifikisht forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave nëpërmjet mundësisht të deklarimeve online të pasurisë për të gjithë subjektet deklaruese, si dhe publikimin e deklarave të interesave private pa kërkesë;
- Prioritetin 3 “*Lufta kundër Korrupsionit*”, si pjesë e udhërrëfyesit për 5 prioritetet kyçe për integrimin evropian të vendit, si dhe në dritën e rekomandimeve të shumta të instrumenteve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë (GRECO, ACFA, Tyso), të cilët kanë evidentuar nevojën e ngritjes së një sistemi elektronik të deklarimit online për ILDKPKI;
- Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018 ku rekomandohet nevoja për rritjen e kapaciteve të mëtejshme administrative, teknike dhe financiare të ILDKPKI me qëllim përballimin e kontrollit të deklarave të interesave private, duke evidentuar mungesën e një sistemi online të deklarimit të pasurive;

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJI LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME. VLERËSIMI I NDIKIMIT.

Projektligji përmban 6 nene të cilat rregullojnë dhe përmirësojnë ligjin ekzistues për çështje që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave private si një prioritet i përcaktuar jo vetëm në dokumentat strategjik në luftën kundër korrupsionit, por dhe nën Prioritetin 3 “*Lufta kundër Korrupsionit*”, si pjesë e udhërrëfyesit për 5 prioritetet kyçe për integrimin evropian të vendit në Bashkimin Evropian.

Projektligji vjen si domosdoshmëri e përsosjes së mëtejshme të kuadrit ligjor aktual për të lehtësuar procesin e ngritjes dhe vënies në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave private, si një mekanizëm i rëndësishëm në forcimin e mjeteve investiguese/kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, me impakt të ndjeshëm jo vetëm në luftën kundër korrupsionit në të gjitha kategoritë e zyrtarëve, të cilët kryejnë funksione publike, por edhe në përmbushjen e pritshmërisë qytetare në rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit të zyrtarët që ushtrojnë funksione publike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NE FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe propozon disa shtesa dhe ndryshime në ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë*”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLES SE PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR AKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me acquis të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 5 nene ku në mënyrë të përmbledhur parashikohet:

Neni 1 i Projektligjit, ndryshon nenin 2, pika 4, 8, 9 që konsistojnë në përkufizime termash dhe që në ligjin aktual i referohen Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Në tekstin e ndryshuar hiqen të dhënat (ekstremitetet e ligjit), duke u riformuluar përkufizimet, sipas standarteve të teknikës legjislative.

Neni 2 i Projektligjit, i cili ndryshon Nenin 3/1 pika 2 të ligjit në fuqi synon që të qartësojë detyrimin që mbartin suubjektet aktuale, të cilët kanë plotësuar dhe dorëzuar më parë deklarata të interesave private, në rast se vendosin të kandidojnë për një vend në organet e drejtësisë. Në mënyrë të qartë ky ndryshim parashikon se këta subjekte nuk kanë detyrim për të plotësuar “deklaratën e interesave private për kandidat në institucionet e sistemit të drejtësisë”, por në momentin e kandidimit do t’i nënshtrohet kontrollit të plotë, duke dalë nga skema e parashikuar nga neni 25/1 i ligjit.

Neni 3 i Projektligjit, i cili ndryshon pikën 1 dhe 3 të nenit 4/2 të ligjit në fuqi, ka si qëllim qartësimin e mënyrës së dorëzimit të deklaratave të interesave private me ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik (online) të deklarimit të interesave private. Me vendosjen në funksionim të sistemit, përparësi do të ketë mënyra e dorëzimit me anë të mjeteve elektronike dhe vetëm në përfundim të procesit të plotësimit dhe ruajtjes, nëpërmjet këtij sistemi, subjektet që mbartin detyrimin për deklarim do të pritojnë dhe dorëzojnë në formë shkresore, pranë strukturave përkatëse, kopjen e deklartës së interesave private.

Neni 4 i Projektligjit, që ndryshon pikën 4 të nenit 26 të ligjit aktual, parashikon mundësinë që dhe inspektorët e autorizuar nga Inspektori i Përgjithshëm, t’i adresojnë kërkesë bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, për të marrë të dhëna lidhur me

depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga personat që, sipas këtij ligji, kanë detyrimin për deklaram. Ky ndryshim vjen si domosdoshmëri e funksionalitetit të sistemit elektronik (online) të deklarimit të interesave private, i cili parashikon ndërveprim me të gjithë institucionet publike dhe private nga të cilat Inspektorati i Lartë, kërkon, merr dhe administron informacion gjatë procesit të kontrollit të plotë dhe/ose hetimit administrativ. Konkretisht, me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, inspektorët e Inspektoratit të Lartë, të ngakuar me kryerjen e proceve të kontrollit, do të kenë mundësi të ndërlidhen me sistemet elektronike të institucioneve publike dhe/ose private, duke ju adresuar kërkesa lidhur me të dhënat e nevojshme për proceset e kontrollit dhe marrjen e informacionit prej tyre. Ndryshimi i parashikuar i hap rrugë institucioneve private për të mos pasur asnjë pengesë ligjore lidhur me komunikimin dhe ndërveprimin, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, me inspektorët e autorizuar nga Inspektori i Përgjithshëm për ushtrimin e kontroleve apo hetimeve administrative.

Neni 5 i Projektligjit që ndryshon pikat 3, 4, 5 të Neni 42/1 në ligjin në fuqi, synon të heqë afatet e mëparshme 3 dhe 5 vjeçare të parashikuara për vënien në funksionim të sistemit elektronik (online) të deklarimit të interesave private, në kushtet kur Inspektorati i Lartë është drejt përmbushjes së detyrimeve të marra përkundrejt partnerëve ndërkombëtarë USAID/Këshilli i Evropës/BE përgjatë vitit 2019. Shfuqizimi i afateve strikte 3 dhe 5 vjeçare do t'i hapë rrugën Inspektoratit të Lartë që me marrjen në dorëzim të sistemit elektronik (online) të deklarimit të interesave private, të fillojë në mënyrë të menjëherëshme fazat e pilotimit, testimit, trajnimit dhe finalizimit të procesit për të gjithë subjektet që mbartin detyrimin për deklaram.

Gjithashtu, ky ndryshim vjen në mbështjet të gjetjeve dhe rekomandimeve të Komisionit Evropian në Raprotin për Shqipërinë 2018 ku është theksuar se: “...sipas datave të synuara të vendosura në ndryshimet e fundit të ligjit, funksionimi i plotë i sistemit të deklarimit të pasurisë online nuk mund të sigurohet para vitit 2022. Kjo duhet të adresohet, në mënyrë që të sigurohet që sistemi të jetë në funksionim brenda një afat kohor më të shkurtër”.

Neni 6 i Projektligjit parashikon të shtojë pas nenit 42/1, nenin 42/2 me përmbajtjen: “1. Për efekt të deklarimit të interesave private të dërguar me mjete të komunikimit elektronik, sipas nenit 4/2 të ligjit, të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrimin për deklaram, detyrohen të deklarojnë: a) Në deklarimin periodik vjetor, gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në 31 dhjetor të vitit të deklarimit; b) Në deklarimin para fillimit të punës, gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit; c) Në deklarimin pas largimit nga funksioni, gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në datën e largimit nga funksioni. 2. Parashikimet në gërmat a) dhe c) janë të vlefshme vetëm për plotësimin për herë të parë të deklaratës së interesave private nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. 3. Inspektori i Përgjithshëm, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj pike”

Ndryshimi i propozuar në ligjin ekzistues duke shtuar nenin 42/2 synon t'i hapë rrugën ligjore plotësimit për herë të parë të deklaratës së interesave private nga subjektet që mbartin detyrimin për deklarim nëpërmjet sistemit të deklarimit me anë të mjeteve elektronike, duke parashikuar detyrimin e tyre për të dhënë: në deklaratën periodike të vitit të parë të deklarimit me anë të sistemit elektronik (online) gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në 31 dhjetor të vitit të deklarimit; në deklaratën parafillimit të detyrës gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit; në deklaratën pas largimit nga funksioni gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në datën e largimit nga funksioni.

Ky ndryshim vjen si nevojë për të mbuluar dhe rregulluar periudhën tranzitore nga sistemi i vjetër i plotësimit dhe dorëzimit në mënyrë shkresore të deklaratave të interesave private në sistemin e ri me anë të mjeteve të komunikimit elektronik. Në kushtet e ngritjes dhe vënies në funksionim të një sistemi elektronik (online) të deklarimit të interesave private, në pamundësi për të migruar të dhënat e deklaratave të mëparshme, të cilat janë dorëzuar, administruar dhe ruajtur tërësisht në format shkresore të paërpunueshëm, subjektet që mbartin detyrimin për deklarim duhet të hedhin të dhënat mbi gjendjen e interesave private në përputhje me këto parashikime ligjore.

Për më tepër, ky ndryshim ligjor mbulon nevojën teknike për të pasur të dhëna fillestare në sistemin elektronik (online) të deklarimit të interesave private me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimit të funksionimit të tij për vitet në vazhdimësi.

Parashikimet e nenit 42/2 do të jenë të vlefshme vetëm për plotësimin për herë të parë të deklaratës së interesave private nëpërmjet sistemit elektronik (online) të deklarimit të interesave private, duke mos ndryshuar mënyrën e deklarimit për vitet në vijim.

VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Referuar ndryshimeve të pritshme për t'u miratuar në këtë projektligj, nuk ka efekte financiare të planifikuara.

DEPUTETE
KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)

